



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 131 / 10 prot.

Tiranë, më 5.2 2026

V E N D I M
Nr. 4, datë 5.2.2026

PËR
PROVIMIN E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në mbështetje të neneve 248, 262, 266 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neneve 52, 53 dhe 58 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si edhe neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 5.2.2026,

V E N D O S I:

1. Të fillojë procedurat për organizimin e provimit të pranimi për vitin akademik 2026-2027, për profilet gjyqtar, prokuror dhe avokat shteti.
2. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatë për magjistratë do të jetë 17 (shtatëmbëdhjetë) kandidatë, nga të cilët 10 (dhjetë) kandidatë profili gjyqtar dhe 7 (shtatë) kandidatë profili prokuror.
3. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatë për avokat shteti do të jetë 7 (shtatë) kandidatë për avokat shteti në nivel vendor (pranë ministrive/zyrave vendore).
4. Periudha e regjistrimit për kandidatët për magjistratë dhe avokatë shteti do të jetë 6 – 28 shkurt 2026.
5. Provimi i pranimi do të zhvillohet në datat:
 - 21 prill 2026 - faza e parë
 - 23 dhe 24 prill 2026 – faza e dytë
6. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për ndjekjen e procedurave të organizimit të këtij provimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.